

VENDIM
Nr. 30/2018

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR PËR TË KONTROLLUAR VEPRIMET
DHE MOSVEPRIMET E ORGANEVE SHTETËRORE NË PARANDALIMIN DHE
GODITJEN E FENOMENIT TË KULTIVIMIT DHE TRAFIKUT TË LËNDËVE
NARKOTIKE, PËRFSHIRË ÇËSHTJEN PËR TË CILËN PROKURORIA PO HETON
Z. SAIMIR TAHIRI, ISH-MINISTËR I BRENDSSHËM**

Bazuar në nenet 77 e 78 të Kushtetutës dhe në mbështetje të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit”, me propozimin e një grupi prej më shumë se ¼ të anëtarëve të pakicës parlamentare,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet Komisioni Hetimor për të kontrolluar veprimet dhe mosveprimet e organeve shtetërore në parandalimin dhe goditjen e fenomenit të kultivimit dhe trafikut të lëndëve narkotike, përfshirë çështjen për të cilën Prokuroria po heton z. Saimir Tahiri, ish-ministër i Brendshëm.

II. Verifikohet çdo lloj dyshimi për ndikim të paligjshëm në ushtrimin e ndjekjes penale në mënyrë të pavarur nga organet kompetente të ngarkuara me ligj, në hetimin penal të këtij rasti.

III. Hetimi synon mbrojtjen e parimit të ndarjes dhe të balancimit të pushteteve, shtetin e së drejtës dhe demokracinë funksionale, me qëllim parandalimin e pasojave negative për shtetin, qytetarët dhe interesin publik, si dhe nxjerrjen e përgjegjësive konkrete institucionale.

IV. Komisioni hetimor, i ngritur sipas këtij vendimi, bashkë me raportin përfundimtar i paraqet Kuvendit në seancë plenare rekomandime në lidhje me nxjerrjen e përgjegjësive institucionale, ndryshime apo miratime ligjesh dhe, sipas rastit, njoftimin e organeve përgjegjëse për marrjen e masave të mëtejshme ligjore.

V. Komisioni hetimor parlamentar përbëhet nga 11 deputetë. Përbërja e komisionit miratohet me vendim të Kuvendit.

VI. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat 6-mujor nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

VII. Ngarkohet Kryetari i Kuvendit që menjëherë të caktojë mjediset dhe mjetet e punës së komisionit, si dhe personelin e nevojshëm, duke vënë në dispozicion edhe ekspertë juristë.

VIII. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit që të marrë masa për zbatimin e vendimit të Kuvendit dhe të urdhrave të kryetarit të Kuvendit, për mbarëvajtjen e punës së komisionit, si dhe krijimin e kushteve të nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të tij.

IX. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 5.3.2018